

## **Procesverbal**

I hartuar më 24.05.2021 në debatin me banorë ne fshatin Lluzhan, ku ishin te ftuare edhe banoret e fshatrave Lluga, Kaqybeg, Batllavë, Gërdoc, Dyz, Belopojë, Tërrnavë, Halabak, Lluga, Sallabajë, Shakovicë, Lupq i Poshtëm, Majac, Lupq i Epërm dhe Popovë.

Temë diskutimi ishte; Propozim Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Podujevës.

Drejtori i Administratës në komunën e Podujevës Bahri Selimi i cili edhe u drejtoi debatin, i informoi të pranishmit mbi të gjitha procedurat e kësaj propozim rregulloreje, e cila është hartuar në bazë te Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 mbi organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Në bazë të këtij udhëzimi administrativ komuna e Podujevës duhet ti formoi 30 këshilla lokale. Me propozim rregulloren komunale është paraparë që 24 këshilla lokale të formohen nëpër fshatra dhe 6 ne qytet. Këto janë vetëm propozime dhe pas debateve dhe propozimeve dhe kërkesave banorëve mund të ndryshohen.

Kjo propozim rregullore qysh ne vitin 2020 ka dal ne diskutim publik por për shkak pandemisë kovid 19 është shtyrë, po ashtu edhe ne vitin 2021 nga asambleja komuna është shtyrë për një kohe ma te përshtatshme. Në mbledhjen e fundit asambleja komunale e ka qit në diskutim publik.

Në bazë të kësaj rregullore nga këto fshatar do të formohen 6. këshilla lokale 1.Lluzhan dhe Lluga, 2. Gërdoc dhe Kaqybeg, 3.Belopojë dhe Dyz, 4. Tërrnavë dhe Halabak, 5. Sallabajë dhe Shakovicë, 6. Lupç i Poshtëm, Majac, Lupç i Epërm dhe Popovë.

Bahrim Selimi theksoi se ne kuadër të këtyre këshillave lokale kemi mundësi me të bëjmë ndonjë ndryshim, nga fshati ne fshat, për ata edhe po i mbajmë këto debate me qytetar.

Pasi që rregullorja te miratohet në asamble komunale, do të formohet një komision gjithëpërfshirës 4 anëtar nga asambleja komunale, një nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një nga komuniteti – fshati.

Rrustem Jetullahu Propozoi që numri i këshillave të kërkohet që të rriten, këshillat aktuale po kemi vështirësi me një fshat e jo me disa fshatra. Propozoi që këshillat të kompensohen.

Shefki Zeqiri këshillat kanë punuar qe 20 vite pa asnjë kompensim. Kjo rregullore nuk është e pranueshme. Udhëzimi administrativë e ka qitë para aktit të kryer me numrin e banorëve.

Komentet dhe vërejtjet te regjistrohen dhe të adreson ne MAPL dhe në asociacion e komunave.

Pati edhe disa vërejtje ne disa nene të rregullores.

Muhamet Murati tha se në bazë të kësaj rregulloreje do të kemi probleme në mes të fshatrave të mëdha dhe të vogël. Në parim jemi kundër kësaj rregulloreje.

Avdullah Qunaku kundërshtojë formimin e këshillave lokale me disa fshatra, fshati Lluga me mbi 2000 banor nuk do të pranoj që të jetë në një këshill me fshatra tjera. Propozimi i këtyre këshillave përngjan në ish bashkësitë lokale apo kooperativat e dikurshme.

Shefki Zeqiri propozoi me i rekomandua asamblesë komunale që mos ta miratoi ketë rregullore deri sa të kthehet përgjigjeje nga MAPL.

Bahri Selimi tha i kuptoi se nuk do të jetë e lehtë formimi i këshillave lokale, duke pas parasysh numrin e madh të fshatrave dhe pozitën gjeografike te komunës së Podujevës.

Do të kërkoi takim me ministrin e pushtetit lokale, do të ia paraqes të gjitha kërkesat e komunitete neper këto debate dhe do te kërkoj nga ministri ndryshimin e udhëzimet administrativ.

Deri sa te jete ne fuqi ky udhëzim administrativ ne jemi të obliguam ne bazë tij.

Podujevë, më 24.05.2021

Procesmbajtësi

Latif mehmeti